



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal

Nr 14, datë 23.11.2023

I mbledhjes së këshillit të bashkisë, e cila zhvillohet në sallën e mbledhjeve në Pallatin e Kulturës “Labëria”(Ora 10²⁰)

Marrin pjesë :

- | | |
|--------------------|----------------------|
| 1.Simo Petromilo | 21.Roland Strakosha |
| 2.Novrus Rrokaj | 22.Eneida Vera |
| 3.Endri Hyseni | 23.Edison Kapaj |
| 4.Ervis Moçka | 24.Gjergji Nika |
| 5.Rajmonda Zoto | 25.Besmir Brahimi |
| 6.Simbol Pazaj | 26.Grigor Dede |
| 7.Lorel Canaj | 27.Arsen Belaj |
| 8.Vullnet Bilbilaj | 28.Englantina Imeraj |
| 9.Liljana Breshani | 29.Alta Haluci |
| 10.Frosina Qyrdeti | 30.Ardian Musta |
| 11.Sokol Kushta | 31.Bujar Osmanaj |
| 12.Myzafer Elezi | 32.Elpiniqi Mërkuri |
| 13.Illir Aliaj | 33.Briseida Çakërri |
| 14.Elca Bezhani | 34.Edlira Kapllanaj |
| 15.Erëmal Arapi | 35.Vjola Xhafaj |
| 16.Liri Dëma | 36.Aurora Qarri |
| 17.Atird Hoxha | 37.Marsela Dashi |
| 18.Shkëlqim Leskaj | 38.Eda Begaj |
| 19.Brikena Sika | 39.Eglantina Aliaj |
| 20.Klodian Xhyheri | 40.Refie Laze |

Mungojnë :

- 1.Brikena Puka

- 2.Anisa Ceno
- 3.Gëzim Çapoj
- 4.Ledia Shollaj
- 5.Jerina Dervishaj
- 6.Mujo Shakaj
- 7.Evis Allushi
- 8.Geron Gunbardhi
- 9.Arjan Isufi
- 10.Dikens Bushaj
- 11.Anxhela Shenaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 14/1, datë 23.11.2023

Znj.Elpiniqi Mërkuri – Mirëmëngjës të gjithëve! Në kuadër të festave të Nëntorit, ta hapim mbledhjen me Himnin e Flamurit.(Ekzekutohet “ Himni i Flamurit“)

Fillojmë me miratimin e procesverbalit të mbledhjes së këshillit, datë 30.10.2023 dhe më pas me shprehjen e ligjshmërisë.

Votohet .

Pro – 35 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA V Lorë
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 14/2, datë 23.11.2023

Znj.Elpinqi Mërkuri – Lexon shprehjen e ligjshmërisë, për vendimet e këshillit të bashkisë Nr 84 ÷ 88 , datë 30.10.2023. Të gjithë vendimet vlerësohen të ligjshëm nga Prefekti i Qarkut Vlorë.

Vazhdojmë me rendin e ditës.

Z.Endri Hyseni – Përsëndetje!. Në lidhje me rendin e ditës, në komisionin Juridik, u diskutua . Pika 7, është një rezolutë, e cila u vlerësua nga komisioni me mangësi. Gjithashtu dhe me propozim nga kryetari i grupit “Bashkë Fitojmë “, u la të ngrihej/bëhej një grup pune dhe të diskutohej me grupet e interesit. Kështu, që në komision, u vendos të shtyhet kjo pikë, jo se s’jemi dakort me rezolutën, por që ta bëjmë rezolutën konformë rregullores dhe procedurave dhe që të votohet unanimisht.

Z.Klodian Xhyheri – Paraqitem një projekt rezolutë. Ku qëndron problemi që tha këshilltari, të bëjmë takim me grupet e interesit. S’janë qëllime politike. Sipas kujt procedure ? Është shumë pak në lidhje me dënimin e dhunës ndaj gruas. Unë i di procedurat. Dorëzova një draft. E dënojmë apo jo ? Merrni nismën, bëni draftin . Duhej mbledhur aleanca e grave këshilltare.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Është mendim shumë i mirë juaji për rezolutën, rezolutën që ta bëjmë aleanca e grave këshilltare. Por dhe për shkak të vonesës, nuk pati kohë, kështu që ta shohin, të shtojnë dhe anëtarët e tjerë, që kjo të dalë sa më e plotë.

Z.Klodian Xhyheri – Ishte idea ime. Ne s’kemi çtë shtojmë.

Z.Ervis Moçka – E mbështesim zotin Xhyheri, është problem social, jo politik. Të kishim mundësi ta shihnim, të krijojonim një grup pune. Rezoluta ka ardhur vonë, kështu që na duhet një afat dhe të dalim me tekst që ta votojmë unanimisht.

Z.Erëmal Arapi – Me këtë llogjikë që thotë zoti Moçka, nuk duhet të kalojnë materialet , që na vijnë me vonesë. Çfarë ka për të lexuar . Të bëjmë debat kot, pse e ka sjellë zoti Xhyheri.

Znj.Alta Haluci – Kjo është thjesht një rezolutë. Çfarë do shtohet . Muaji Nëntor, përveç muajit

të festave , është dhe muaji kundër dhunës. Pra, jemi në këshill...është dhe muaji i luftës kundër dhunës së grave.

Zoti kryetar ! Lexoni axhendën tuaj të aktiviteteve . Vlora nuk është Vlora e Lirisë, por Vlora e Pavarësisë. Të bëhet më shumë. Mbjaj mend 100 vjetorin e Pavarësisë, ku u bashkuam të gjithë. Le të themi, që Vlora për 1 ditë, të jetë kryeqyteti i Shqipërisë dhe, jam e mendimit që, Vlora është e Pavarësisë dhe të jemi të gjithë së bashku që Vlora të marrë vëmendjen e të gjithëve.

Z.Atird Hoxha – Përsa i përket rezolutës, besoj që, s'ka gjë për të diskutuar, sepse kjo ka ardhur si pasojë e përdhunimit të një vajze, ku këtu brenda grupit të këshilltarëve ka të afërm. Mos u bëni mburrojtë, ka vetëm të bëjë me luftën kundër dhunës së grave. Prandaj, kot janë këto, të mblidhet grupi, doni të mbroni...

Z.Ervis Moçka – Për procedurë. Është një propozim që të gjithë e pranuan . Dhamë dakortësinë, do punonim në një grup të përbashkët. Komisioni juridik, meqenëse s'kanë mundësi , vendosi ta shtyjë për të krijuar grupin, për tu njohur të gjithë. Flas për çështje proceduriale.

Z.Ilir Aliaj – Përsa i përket rezolutës , ishte zonja Liljana, nga PS, që kërkoi nga ne të dënonte këtë dhunim , për ngjarjen që ndodhi. E përkrahëm dhe pas saj u ngrit kryetari i grupit “BF” për krijimin e një rezolute. Shkaku që po flas,nuk ishte çështja e rezolutës, por për zonjën që thotë për Vlorën e Flamurit,... por ne që donim Vlorën, për 100 vjetorin partia jonë e bëri atë lloj organizimi, që do mbahet mend.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Votojmë rendin e ditës, me propozimin e zotit Hyseni .

Pro – 29 vota

Kundër – 9 vota

Abstenim – 1.

Miratohet rendi i ditës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA V Lorë
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 14/3, datë 23.11.2023

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në pikën 1 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e bashkisë, për muajin tetor 2023”. Një relacion nga drejtoria përkatëse.

Znj.Irena Stasa – Ndihmë ekonomike, nga të ardhurat e bashkisë, përfitojnë 32 familje, në njësi e rajone , me një fond prej 105.500 lekë/ të rinj.

Është 1 familje, që futet për herë të parë , me kushte të vështira social – ekonomike;
Familje që nuk do trajtohen , janë familje që aplikojnë.....çdo muaj futet dhe kjo familje.

Znj.Elca Bezhani – Mendoj që të kalojnë këto dy projektvendime të ndihmës ekonomike. Zonja ka relatuar dhe në mbledhjen e komisionit në lidhje me këto dy projektvendime . Komisioni i financës, vendosi të kalojnë këto dy projektvendime.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë për miratim, ndihmën ekonomike nga të ardhurat e bashkisë.
Votohet.

Pro – 35 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet .



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 14/4, datë 23.11.2023

Znj.Elpiniqi Mërkuri – Pika 2 e rendit të ditës, miratimi i projektvendimit “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar, për muajin tetor 2023”. E kalojmë në votim.

Votohet.

Pro – 35 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 14/5, datë 23.11.2023

Znj.Elpinqi Mërkuri – Viojmë me pikën 3 të rendit të ditës, me miratimin e projektvendimit “Për miratimin e numrit të punonjësve dhe nivelit të pagave të bashkisë, institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara – 2024”. Relaton drejtoresha përkatëse, kryetari i komisionit dhe më pas kalojmë në diskutime.

Znj.Laura Brinja – Bashkia Vlorë, ka paraqitur këtë projektvendim për ndryshimin e numrit të punonjësve, bazuar kjo në nenin 53, të ligjit “Për Vetqeverisjen Vendore “. Është e drejtë e këshillit të bashkisë për miratim.

Numri i punonjësve nga 283 , bëhet 318.

-Ndryshimi i riorganizimit i Shtëpisë së Foshnjës me Qendrën PAK. Është një projekt i Ministrisë së Shëndetësisë, do të kalojnë nëpër familje .

Në Qendrën PAK, është e nevojshme rritja e numrit të punonjësve

-Klubi Shuësportësh, mbulon 5 ambjente. U pa e arsyeshme të rritet numri i punonjësve, nga 16 në 18 , pra rritet me 2.

Z.Erëmal Arapi – Pyetja e parë: Në komisionin e ekonomisë, ka kaluar apo jo?

Së dyti, nga administrata, ristrukturimi i nisur nga kryetari i bashkisë. Është rritur numri në 35. Argumenti është, riorganizimi i policisë bashkiake . Të 35 do të shkojnë për ristrukturim e policisë bashkiake ? Nëqoftëse jo, ku do jetë kjo rritje.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Për proçedurë, kryetare e komisionit të ekonomisë

Znj.Elca Bezhani – Ky projektvendim(Lexon), u trajtua në komisionin e financës. Duke u parë relacioni i përgatitur, në komision kishte debate dhe diskutime. Ligji Nr 139/2015, neni 9 (Lexon)..është lidhur me numrin e punonjësve dhe organikën..., është e drejta e kryetarit të bashkisë. Në fakt, diskutimet dhe debatet ishin , pasi materiali nuk ishte i bazuar , argumentimi në lidhje me këtë rritje të numrit të punonjësve.

I lamë detyrë drejtoreshës së administratës për një relacion të detajuar, lidhur me këtë rritje të numrit, dhe kryesisht ristrukturimin e policisë bashkiake.

Kryetari i bashkisë, ka të drejtë të miratojë , numrin e punonjësve të policisë bashkiake.

Relacioni shtesë, erdhi. Në komision kishim të njëjtat mendime . I bëmë vërrejtjet administratës, e cila duhet të reflektojë. Edhe për rritjen e pagës, pritet të dalë një VKM.

Komisioni nuk e kaloi, prandaj e lamë në këshill për diskutim.

E diskutuam në komision. Po flas për komisionin ekonomik, kam ftuar dhe kolegët e opozitës, erdhi relacioni. Ndryshimet për tek Shtëpia e Foshnjës me Qendrën PAK, shtesa tek Klubi shumësportësh , argumentat ishin.

Z.Erëmal Arapi – Kur e nisi zonja Bezhani , paskan ardhur dokumentat, mendova se zonja do ta shtynte35 janë vetëm për policinë bashkiake? Nëqoftëse Jo? Ku?

Ka argument, cili nen, numrin e kalon këshilli i bashkisë . A ka ndonjë material, sa është numri i punonjësve?

Efekti financiar , si do ti gjeni ?

Të ardhurat i keni , me minus. Si do ta nxirrni , mos e keni shtimin politik. Nëqoftëse, e keni për efektin publik, sqarojeni.

Z.Gjergji Nika – Iniciativa është e kryetarit të bashkisë. Organigrama , kryetari nuk është, pra të na vijë kryetari ose ndonjë tjetër, jo të gjitha mbi drejtoreshën e burimeve njerëzore.

Të vijë Nën/kryetarët, ti japin seriozitet kësaj gjëje.

Ne po ngrejmë pika në të mirë të strukturës së bashkisë. Na jepni analizë financiare, argumenta binbëse.

Z.Atird Hoxha – Bashkohem me shqetësimin e zotit Nika që mungojnë, që sidomos në lidhje me këtë pikë kaq të rëndësishme, mungojnë titullarët.

Numri në total – 1471 vetë në Bashkinë Vlorë me gjithë institucionet në varësi. Për këtë keni kohë ta lexoni, edhe pse erdhi relacioni me vonesë, për rezolutën nuk kishit.

Të ardhurat në fashën 50%. Nëqoftëse, ne shtojmë numrin e punonjësve të bashkisë çdo vit, do të shkojë shumë. Por, më shumë problematike janë taksat e qytetarëve. Juve zonja kryetare duhet të tërhiqni vërrejtje kryetarit të bashkisë, nënkryetarëve dhe administratës. Po mbushet administrata me shokë e me shoqe.

Punonjësit e pastrimit. Duhet të informohemi, në komision nuk ka kaluar. Ju jeni në konferencën e kryetarëve dhe merrni dijeni për këto, të mos e kaloni. Janë shtesa të paargumentuara.

Z.Ervis Moçka - Mirë ishte , të dëgjonim dhe drejtoreshën., megjithatë 2-3 tema...Nga ana proceduriale, nuk ka asgjë, e ka rregullorja edhe pse s'kalon në komisione , është e drejtë të kalojnë në mbledhjen e këshillit. Relacion më të plotë kanë kërkuar anëtarët e komisionit . Unë relacionin e kam lexuar. Komisioni nuk e miratoi, por i kalo këshillit për shqyrtim.

Shumë janë funksione të deleguara, pra nuk paguhen të gjithë nga buxheti i bashkisë.

Numri 1471; nuk paguhen të gjithë nga bashkia..., sepse po ju drejtohem qytetarëve vlonjatë.

Paguhen dhe nga buxheti i shtetit. Është e drejta e kryetarit të bashkisë të miratojë numrin, dhe këshilli. Diskutohet numri 35. Me kaq policë sa ka sot, është bashki e madhe , me 4 njësi ...Ia del policia të shkojë në të gjitha njësitë , gjithë plazhet..., dhe ju diskutoni rritjen e numrit të policisë.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Ju lutem...

Z.Gjergji Nika – Në realitet, ishim 3 kundër me 2 pro, në komision.

Nga 35; 2 për pallatin e sportit dhe për Qendrën PAK, jemi “ok”. Ne në komision kemi të drejtë të sygjerojmë dhe nuk bëhet asgjë. Kemi diskutuar për rritje page për policinë bashkiake dhe specialistët...Nuk janë marrë parasysh. Materiali që na vjen .., 10 të tjerë, çfarë do bëhet . Flitet do bëhet me drejtor të përgjithshëm, njësoj si Tirana.

Nuk jemi kundër rritjes së numrit , i argumentoni , i bëni njëherë efiçentë, pastaj rrisni numrin. Është folur për rritje page të policisë bashkiake dhe nuk ka patur fond.(Lexon klasën e pagave , pozicionet e policisë bashkiake) krahasuar dhe me Bashkinë Durrës. Në fund të propozimit, shkruhet shtesë 2%, them që të unifikohet; Edhe shtesa 1% përmbi vjetërsinë..

Për zbatimin e këtij vendimi , ngarkohet Kryetari i bashkisë ...

Pika më e rëndësishme , që ti vlerësojmë këta njerëz.

Vlera shtesë e nivelit të kualifikimit ...niveli – 7 (lexon)

Pse Bashkia Vlorë, si paguhet ..është me ligj. Ne duam informacion shtesë, prandaj e rrëzuar (lexon struktura e Bashkisë Tiranë) Në bashki po rritet shumë numri i drejtorëve të përgjithshëm , nënkryetarëve. Ristrukturimi, bëhet brenda shportës që ti ke .

Pjesa, që themi do rritet niveli i pagave ..., keni rritje me 69, staf të ri. 22 punonjës, i rritëm për shërbimin e varrezave, pra, është rritur numri. Do bërë analizë.

Elektriçistët paguhën , me 4700. Jemi dakort për rritjen e pagave dhe numrin e punonjësve..Duhet bërë ..duhet të merrni parasysh sygjerimet. S’ka gjë në vijë, që nga komisionet. Flas me integritet, jo politikisht.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Administrata të japë përgjigje.

Znj.Laura Brinja – Zoti Nika, për këshillin në Bashkinë Durrës, i janë referuar VKM nr 325, për pushtetin qëndror. VKM nr 328 është për pushtetin vendor. Me këtë vendim, për shtesë pozicioni .., vetëm shtesë pozicioni..Vlerësimi për punonjësit Diploma – 100,120,140

Vjetërsia – 1% ; 2% mbi diplomën...pra i jemi bazuar VKM nr 328. Për punonjësit administrativë, është 47 .

Ky ishte interpretim i VKB Durës. Për sqarim, për rritjen e numrit të policisë bashkiake – në 25 , rritje në policinë bashkiake

3 drejtorë të përgjithshëm, pjesa tjetër, pjesë e administratës, specialistë në drejtori. Është drejtori i policisë bashkiake.

Z.Erëmal Arapi – Përgjigjen për 7 persona, nuk e morra. Drejtori ekonomik, a ka bërë ndonjë analizë , nga do vijnë këto të ardhura

Znj.Laura Brinja – projektvendimi është bërë dhe në prezencë të drejtorit të financës dhe do paraqitet në buxhet . Bëhet një analizë financiare. Ju keni të drejtë të miratoni numrin dhe pastaj bëhet organigrama.

Z.Myzafer Elezi – Zonja drejtoreshë, kur argumentuat ato çka tha zoti Gjergji, krahasuar me bashkinë Durrës, jeni bazuar në VKM nr 328/2023, “Për klasifikimin e ... Për bashkinë Durrës,

nuk është shkelje.

Znj.Laura Brinja – VKM nr 325 ishte për pushtetin qëndror. VKM nr 328 , këtë aplikojmë ne.

Z.Myzafer Elezi - pse citon VKM, për pushtetin qëndror ?

Z.Ervis Moçka - Ka cituar, por ka reflektuar tjetër.

Znj.Laura Brinja – Jemi në maksimumin e pagave të policisë bashkiake.

Z.Emiljano Islamaj/Dr.P.Bashkiake – Sa për pjesën e policisë Durrës, kam qenë unë nismëtar.

Ky është në shkelje. Inspektor policie dhe punonjës në policinë bashkiake, është kategoria 4A...Nuk mund të bëhet, është shkelje nga KLSH.

Znj.Laura Brinja – Do bëhet drejtor drejtorie, jo drejtor i përgjithshëm.

Z.Grigor Dede – Në komisionin e financës u diskutua shumë, të gjitha qëndrojnë . Në 6-mujorin e parë të 2024..... Në komision pati këshillime, diskuime për pagat, për klasat. U kërkua relacion.

Edhe pse nuk kaloi në komision, ju ftoj ta miratojmë këtë projektvendim, pasi asnjë nga ne nuk e di vizionin e kryetarit të bashkisë. Aktualisht, numri i punonjësve në administratë , sidomos ai policëve, është mëse i domosdoshëm. Është shumë terriotor për Bashkinë Vlorë, për këtë numër policësh. Edhe më shumë do të ishte i nevojshëm. Janë rritje mëse të nevojshme. Nëse nuk miratojmë strukturën, pengojmë dhe buxhetin, pra janë dy projektvendimet më të rëndësishëm. Doni ta pengoni? Nuk mund të pengojmë procedurat , strukturën dhe më pas buxhetin.

Propozimi im , është që të gjithë këshilltarët të votojnë pro këtij projektvendimi .

Z.Sokol Kushta – Tek turizmi, nuk pashë gjë, sidomos tek ajo muzeale, janë rritur numri i turistëve, ciceronëve..Nuk është gjë e vogël. Një sygjërim, ta shohi drejtoresha këtë. E shoh si të pavlerësuar. Duhet ti shohim në pagesë. Këto për rritjen e performancës.

Znj.Elca Bezhani – Është një propozim nga drejtori në muze, punonjësja bën 2 detyra, ciceronin dhe arkivën, pra nga klasa 4A në 4B. Të shihet.

Organigrama është dokument shumë i rëndësishëm. Sot kemi vetëm miratimin e numrit , më pas buxhetin. Të gjitha ato që kemi kërkuar 600, 601..kemi të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet.

Këto më vonë në momentin e buxhetit. Ne do të jemi pjesë e hartimit të buxhetit.

Z. Kozma Mali/DFBK – Në lidhje me efektet financiare, patjetër që do ketë shtimi i këtij numri punonjësish. Jemi duke hartuar dhe buxhetin. Prandaj, po bëjmë dhe rritje të numrit të policisë..... Sqarimet e tjera , kur të miratojmë buxhetin.

Z.Gjergji Nika – Po të dëgjoj për atë çka argumentuat. Jemi dakort me rritjen ..Kemi aktorë me pagë të ulët...Na jepni nivelet dhe hajdeni të diskutojmë - 69 veta më shumë, rritje për pagat , vitin 2024 – 47,6%.

Z.Daut Zëraj - Janë shpenzimet operative, kanë ndikim si për pastrimin, shërbime të tjera.

Z. Klodian Xhyheri – Ky projektvendim e kishte një të re. U diskutua në komision .Vendimin e drejtorit të drejtorisë...po fryhet shumë administrata, shpopullimi etj. Kemi një shqetësim. Ka emra në administratë, pasi reflektohet vetëm si emra, por në vendet e punës , jo.

Znj. Elpiniqi Mërkuri – Këta marrin rrogat dhe nuk shkojnë në punë ?

Z.Klodian Xhyheri – Pra marrin rrogat, kanë emrat nëpër letra.

Znj.Elpiniaqi Mërkuri – Nëqoftëse, keni fakte, i sillni me shkrim.

Z.Ervis Moçka – Vijnë në konkluzion. U diskutua.Kryetari i grupit thotë që ka fryrje, por gjithë komisionet dhe ne, në lidhje me numrin 25, të punonjësve të policisë bashkiake. Merak kini si do bëhet organigrama ? Është e drejta e kryetarit të bashkisë. Ne e miratojmë, por kryetari i bashkisë jep llogari 1 herë në 4 vjet. Ne sot na takon të miratojmë numrin total. Drejtori i financës, sot nuk ka asnjë të drejtë të bëjë sot. Mbas numrit bën llogaritë 600, 601 ..Ju ftoj ta hedhim në votim .

Znj.Elpiniaqi Mërkuri – E hedhim në votim.

Pro – 26 vota

Kundër – 11 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA V Lorë
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 14/6, datë 23.11.2023

Znj. Elpiniqi Mërkuri – Kalojmë në pikën 4 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “Për dhënien e mendimit për ndryshimin e nivelit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin dhe përpunimin e ujrave të ndotura.

Z.Gjergji Nika – Në mbledhjen e komisionit, ishin 4 vota kundër .

Z.Illir Aliaj – Ky projektvendim erdhi në komisionin e infrastrukturës..Gjej shkas, u bëj thirrje gjithë këshilltarëve që të marrin pjesë në mbledhjet e komisioneve, ku të japin mendimet e tyre. Relacioni nga Ujësjiellësi nuk kishte argumenta bindës, kishte një tabelë me rritjen përkatëse, por jo një argument , si :

Rritja e çmimit të ujit, jo vetëm për Bashkinë Vlorë, por inisiativë e ERU, jo vetëm për Bashkinë Vlorë. Nga informacioni, drejtoresha ka përgatitur një relacion shterues, ta argumentojë dhe, nëqoftëse bindemi, ta kalojmë.

Z.Atird Hoxha – Siç e thashë dhe më parë , edhe ky projektvendim u rrëzua në unanimitet , u refuzua. Nëqoftëse dhe në projektvendimin e mëparshëm, kishte shumë diskutime dhe nuk kaloi në komisionin e financës...Nuk e kuptoj si ka arritur ky projektvendim, sot.

Zonja kryetare! Jeni ju që e keni futur sot në mbledhje, në këtë rend dite. Nga drejtoresha e ujësjiellësit, mos të relatohet, mos të diskutohet. Ju duhet të merrni një vendim, që të futet ky projektvendim sot apo jo .

Znj.Elpinqi Mërkuri – Rendin e ditës nuk e vendos unë, por kryesia e këshillit.

Z.Gjergji Nika - Mendimi nga ERU dhe jo vendim. Ka arsye të tjera

Prodhon 23 mln m3 dhe faturon 5mln m3. Nëqoftëse ka një relacion..Zoti Moçka , tha për rezolutën që erdhi vonë dhe sot nuk erdhi relacioni nga drejtoresha e ujësjiellësit.

Në vitin 2019 – çmimi ishte 45 lekë

Për vitin 2024 - do shtohet 15 lekë. Bëra analizën për shtëpinë time.

Doni të rrisni, çmimin, por s’kanë ujë .Jemi të ndërgjegjshëm, sensibil për qytetarët. Jo ta marrim ne përgjegjësinë, unë kundër jam. Në komision ishin 4 kundër.

Z.Ervis Moçka – Për rezolutën e kemi diskutuar , ndërsa për futjen në rendin e ditës... Komisioni

nuk ka të drejtë ta pengojë , kështu e ka rregullorja. Pra, komisioni rekomandon. Projektvendimi ka ardhur për dhënie mendimi. Pra, zoti Nika. Kur falimenton, sido mëkëmbesh? Do investosh.

Sot ky ujësjellës, ka nevojë për investime, por nuk mundet. Po kontraktohet . Atëherë , ERU merr vendimin final në këtë tarifë. Vlorë e ka më të ulët. Ka ardhur i detajuar.

Z.Atird Hoxha – Duhet të flas para drejtoreshës.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Të flasë drejtoresha, të japë sqarim më parë .

Z.Atird Hoxha - Përsa i përket këtij projektvendimi, i cili nuk do ishte fare sot ...këshilltarë opozitarë ju kanë paralajmëruar ...Ishte çmimi 45 lekë rritet në 60 lekë/m³. Është një rritje, është rritja e dytë, ku nga 35 në 45, pas miratimit nga këshilli i bashkisë, i kalon ERU. Risni çmimin dhe ujë qytetarët nuk kanë. Këta të ujësjellësit , përfshirë këtu dhe kanalizimet, vëllezërit HysaKa ardhur një relacion , ku në Lungomare janë 4 pika që derdhen ujrat e zeza.

-Është një projekt në sirtar për Vlorën prej 300 milionë lekë, nuk është vënë akoma në punë.

Tenderin që e fiton , mbas investimit të bërë , firma duhet ta kthejë në gjendjen e mëparshme.

-Përsa i përket investimit prej 8 milionë eurosh, për ujësjellësin Novoselë.

-Gener 2 , pse nuk ka përfunduar ?

-Ujësjellësi në lagjen “Partizani “...Sa ujë shkon në këto familje ?

Zonja kryetare, kam qenë dhe në këshillin e mëparshëm. Nëqoftëse, ne tani ngremë kartonin, ne s’kemi bërë gjë para qytetarëve . Edhe komisioni ishte kundër, u është dhënë urdhër për të ardhur sot dhe për të rritur çmimin. Unë jam kundër. Nëqoftëse, do investohet në të mirë të qytetarëve, vota ime është , pro.

Z.Ervis Moçka – Kontraktori u përmend, pasi investimet të bëhen, u interesova dhe për gjendjen e rrugëve që nuk kthehen në gjendjen e mëparshme, bëhet prova e presionit.

Znj.Alta Haluci – Kemi diskutuar shumë , edhe unë jam kundër. Kur u bë bashkimi i ujësjellësit, shumë shpejt u bë dhe rritja e çmimit. Pra, do vazhdojmë të paguajmë. Jam shumë e bindur, që nëqoftëse, do të bëhej votimi i fshehtë, asnjë nuk do të votonte pro. Uji shkon shumë shtrenjtë. Po ata në gjendje të keqe ekonomike . Unë jam kundër këtij projektvendimi. Vota ime, është kundër.

Z.Myzafer Elezi - Më vjen keq, që sot kemi një draft që bie e ndesh me interesat e qytetarëve të bashkisë Vlorë.Relacioni, nuk është bindës për planin e investimit për ujë , 24 orë.

Pse duhet të marrim këtë vendim ne, kur 51% i ka shteti dhe 49% bashkia. Në janar të 2024, e marrin ata. Pse duhet të marrim një vendim jashtë juridiksionit tonë. ERU kërkon vetëm mendimin tonë. Ka shumë kosto uji që blejmë, pomat (energji etj..) Vota ime është kundër. Mos ta kalojmë fare për votim, ti’a kthejmë mbrapsht ...uji të na vijë 24 orë.

Znj.Rajmonda Alliaj – Në këshill kemi sjellë një relacion. Dje kemi sjellë një informacion shtesë. SH.A.Ujësjellësi , jemi shoqëri tregëtare. Duhet të ketë çmim shërbimi, çmimi nga shoqëria . Shoqëria kërkon rritjen e tarifës. Ka një procedurë, bazuar në ligjin nr 8102/1996 . Bazuar në këtë ligj, ka dalë vendimi i ERU-së. Neni 10, plotësimi i dokumentacionit. Janë 15

pika , pika “g” duhet mendimi i pushteteit vendor dhe, më pas shprehja e ligjshmërisë. Në muajin qershor 2023, janë bërë ndryshimet e vendimit. Përse kemi kërkuar rritjen e tarifës? Në vitin 2019 – sipas llogaritjeve dilte 78 lekë kosto nga ne dhe këshilli për familjarët , vendosi 45 lekë. Kemi qenë nën kosto. Me VKM kanë ndryshuar pagat e punonjësve. Kjo , përkthehet në kosto për pagat..Nga 2013 – 2023, kemi rritje të shumta. Çmimi i energjisë nga 2019 – 2023 , 55% dhe pagat e punonjësve..., përkthehen të gjitha në kosto.

Çmimi që unë marr , është 45 lekë/m3 për familjarët. Edhe këtu jam nën kosto. E njëjta kosto është dhe për largimin e ujrave të ndotura. Edhe këtu jemi nën kosto. Ujësjellësi i Vlorës, ka përcaktuar disa prioritete si, reduktimin e ujrave , furnizimi me ujë të pijshëm dhe të pastër ... Ka një plan masash për vjeljen e debive. Nga këshilli bashkiak, kërkojmë mendimin për të vazhduar më tej.

Znj.Briseida Çakëri – Përsa i përket rritjes së çmimit të ujit, janë më të prekshëm pensionistët dhe familjet në nevojë. Nëqoftëse mendoni ta kalojmë, të vihet ose bëhet subvencion për këto shtresa.

Z.Gjergji Nika – Prodhoni 23 mln m3 dhe shet 5mln m3...Shet 22% të prodhimit...nuk të del kostua. Me këtë rritje sa të shkon kostua ? Çfarë ndryshon ?

Znj.Rajmonda Alliaj – Do një ndryshim

Z.Gjergji Nika – Me këto ndryshime, sa të shkon kostua.

Znj.Rajmonda – 117 për popullatën

Z.Gjergji Nika – Prodhon 23 mln dhe shet 5 mln.

Znj.Elca Bezhani – Nuk është e njëjta gjë.

Z.Gjergji Nika – Rriteni taksën, spl, le ta marrë vesh qytetari.

Z.Shkëlqim Leskaj – Kam qenë drejtor në ujësjellës. Kolegët kanë të drejtë për disa gjëra.

Shërbimi i qytetarit, furnizimi me ujë , s’janë. Por nuk do të thotë të mos e përmirësojmë .

Nga informacini që kam, vetëm Tirana dhe Korça e përballojnë, ndërsa gjithë të tjerët, dalin me humbje. Kemi pas rritje në vitin 2019, nga 30 në 45 lekë. Shpenzimet kryesore janë paguar, pagesa e OSHE, materialet etj...Sot është rritur paga minimale.

Z.Gjergji Nika – Është dyfishuar numri i punonjësve.

Z.Shkëlqim Leskaj – Ndryshimi i pagave, varret nga koefiçenti, kemi rritje të çmimit të energjisë, karburantit, klorit, bazës materiale..., të gjitha kanë rritje.

Prodhohet 23 mln, vjelja 5 mln. Humbja më e madhe është në rrjet., ka amortizim rrjeti.

Bashkia Vlorë , është një nga katër bashkitë , kemi partner KFË dhe kanë disa kritere, si dhe rritjen e çmimit. Rritja e arkëtimeve me forcë shtrënguese..Ata miratojnë dhe investimet në ujësjellës. Duke u krahasuar dhe me bashkitë e tjera ..nëqoftëse kërkojmë shërbim, duhet të kemi investim,duhet të kemi rritje të çmimit të tarifës për tju afruar koston. Për të pasur një cilësi në shërbim , si në furnizimin me ujë

Z.Erëmal Arapi – Donacion me kusht për të rritur çmimin. Ne nuk na është shpjeguar akoma që, ujësjellësi s’ka paguar bashkinë, si agjent tatimor. Po e votoj kundër këtë mendim. Jepni dhe ju

mendimin kundër, të jeni të pastër me veten tuaj.

Z.Klodian Xhyheri – Kryetari i grupit , u tha falimentuar ujësjellësi, nga goja e tij. Për dhënien e mendimit, ky projekt vendim, është rritja e çmimit.

51% në favor të AKUMI. Lëvizja e parë e AKUMI-t, u bë, e prisnim. Kjo rritje çmimi është në kurriz të konsumatorit familjar, që është fasha më e varfër.

Fasha e biznesit, edhe mbi këtë do të rëndojë. Do ti rrisin të gjitha taksat dhe tarifat ...Gjithmonë pas “rritjes së çmimit...shoqërohet me reformim, rritje performancePra, rritet çmimi , pa shërbim. U bë dëgjuesë publike, qytetarët ju kanë masakruar atë ditë. Rritja e çmimit të ujit , është e pajustificueshme, me ato që na sillni në këto materiale, jemi kundër. Duan shërbimin, pastaj rritjen e çmimit.

Z.Ervis Moçka – Kemi një ndërmarrje me probleme, iu drejtova zotit Nika, që çfarë bën ti që ekziston një ndërmarrje me probleme...

Të gjithë e ndoqëm me vëmendje relacionin që bëri ish-drejtori i ujësjellësit. Analiza ishte shumë e saktë. Taksa ndryshon nga tarifa. Tarifa paguhet dhe jepet shërbim. Por, ky shërbim është nën kosto , u sollën në analizë duke u krahasuar dhe me bashkitë e tjera, çmimet e tyre.

Që të thithësh këto investime, ka disa kritere, si rritja e tarifës, shërbimi, rritja e faturimit etj..Pra, ne sot na kërkohet të japim mendim për më shumë investim.Asnjë nga ne nuk do të donte që të gjithë këta donatorë, për ujësjellësin e bashkisë ...

Prandaj, mendoj, ta kalojmë në votim

Znj.Elpinqi Mërkuri – E kalojmë në votim.

Pro – 26 vota

Kundër – 11 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 14/7, datë 23.11.2023

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në pikën 5 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit“ Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia e banesës së zotit Erjon Jonuzaj, zotit Artan Jonuzaj dhe zonjës Lutfie Fanaj, dhe shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë”. Një relacion nga drejtoria përkatëse.

Z.Aulon Spaho /DMC – Në projektvendimin që kemi paraqitur, janë 3 familje që përfitojnë ndihmë financiare nga djegia e banesave; zoti Erjon Jonuzaj, zoti Artan Jonuzaj dhe zonja Lutfie Fanaj. Vetëm me një korrektim të vlerës nga 144,... në 149, 4..
Ftojme këshilltarët ta miratojnë.

Znj.Elpinqi Mërkuri - Kur të zbardhet vendimi, të bëhet me ndryshimin e vlerës.

E kalojmë në votim.

Pro -29 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota.

Disa s'morrën pjesë në votim.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 14/8, datë 23.11.2023

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në pikën 6 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “Për miratimin e programit të punës të aktiviteteve të Këshillit të Bashkisë Vlorë, për periudhën janar – dhjetor 2024 “.

Është programi i punës së aktiviteteve që do të zhvillojë këshilli, për vitin 2024.

E kalojmë në votim.

Pro – 29 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Disa nuk morrën pjesë në votim.

Miratohet



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 14/9, datë 23.11.2023

Znj.Elpinqi Mërkuri – Vazhdojmë me Pikën, “Të ndryshme “
Kush e do fjalën ?

Z.Myzafer Elezi – Do të paraqes disa probleme e shqetësime të ngritura dhe më parë . Në muajin tetor kemi paraqitur disa shqetësime me shkrim

1.A është përfshirë në buxhetin e bashkisë për vitin 2024 , rruga Bestrovë – Bunavi ?

2.Rruga “ Gani Bejkosala “. Zonja nënkryetare e bashkisë thatë që do ti trajtoni. A e keni merrë në konsideratë shqetësimin tonë ?

3.Shqetësim nga banorët e “Fushës së Aviacionit “ , punimet e ndërprera, prej 1 viti në këtë lagje. Përse janë ndërprerë dhe a mund të përshpejtohen procedurat. Rruga është e shkruar, por jo e asfaltuar, është me gropa . Kërkoj impenjimin tuaj.

-Shqetësim tjetër nga banorët e lagjes “Uji i Ftohtë “ , për shërbimin publik. Në stacione mungojnë tendat. Të merren masa për vendosjen e tyre.

Z.Zambak Selmani/DIIP – Rruga Bestrovë – Bunavi , është përfshirë në buxhet. Do të bëhet.

-Rruga tek “Fusha e Aviacionit “ po punohet. Nuk është pjesë e bashkisë, ne jemi përfitues, është investim i qeverisë. Nuk është e vërtetë, që nuk po punohet. S’ka pas asgjë më parë atje. Sot ka rrugë, ndriçim.

-Në lungomare , jemi përfitues, nuk jemi projektues. Nuk e lejon projekti për tendat në stacione, është projekt i qeverisë . Jemi në mirëmbajtje. Nuk ndërhyjmë dot, nuk është projekti ynë.

Z.Atird Hoxha – Nga ish- posta e Skelës deri tek Rrapi, ka kosha, ndonjë kontenier ...

Z.Zambak Selmani - Në lungomare do të ketë kontenierë të nëndheshëm. Nga “Bolonja” deri tek rrethi, janë vendosur të rinj. Të gjithë janë thyer.

Projekti i lagjes “Fusha e Aviacionit “, do të përfundojë, do ti’a kërkojmë tek FSHZH.

Z.Illir Aliaj - Në mbledhjen e mëparëshme, kam kërkuar për tek zona e “Fabrikës së Çimentos “, ura , bllokimi i asaj ure, është problem.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Këto ditë do fillojë pastrimi i kanalit dhe urës.

Z.Illir Aliaj – Projekti i ujësjellësit, nuk di çfarë është bërë me ato kanalet. Pra, rruga është bërë,

është kthyer në normalitet.

-KUL është totalisht i bllokuar. A është marrë ndonjë masë ?

-Meqenëse sot kaluam dhe rritjen e tarifës së ujit, të gjitha lavazhot, 80% e tyre , punojnë me ujë të pijshëm. Pres drejtorin e policisë bashkiake , çfarë do bëhet ? Të shihet ky problem.

Z.Zambak Selmani - Të sqarojmë...investimet në lagjen “Karabash”, “Partizani “, është lidhur kontratë me ujësjellësin.

-Ujësjetësi i Novoselës, nuk është se ka ngelur për shkakun tonë dhe të opozitës. Nuk ka mbaruar.

Z.Atird Hoxha – Ti ke infrastrukturën.

Z.Zambak Selmani – Por kam kalendarin e punimeve. Afatet nuk i përcaktojmë ne, por ujësjellësi.

Z.Atird Hoxha – Po ka afat fillimi dhe përfundimi.

-Po rruga e Unazës, është marrë në dorrëzim?

Znj.Elca Bezhani – Para dy mbledhjeve , kam ngritur disa problematik. Doja të mëshoja, në lidhje me mendimin e zotit Elezi , në lidhje me ndriçimin në fshatin Trevllazër, si dhe zhbllokimin e rrugës hyrëse .

-Për post problemit të ujit të pijshëm në fshatin Panaja dhe Oshëtimë.

-Ligji “Për administratoret”. Nuk di çfarë po bën administrata e bashkisë.

-Propozim, sektorit të kulturës , të na vijë kalendari i aktiviteteve për vitin 2024. Në lidhje me projektin “Aulona “Folk, të planifikohet në buxhetin e bashkisë, të përfshihet në buxhetin e bashkisë.

Znj.Liljana Breshani - Do theksoj vendimin nr 475/2021 “Për bashkëpunim me shërbimin veterinar ..” Dua të theksoj, pikën 3...mbikqyrja e qenëve endacakë, pa pronar ..., e ka nën kontroll.

Çfarë masash ka marrë dhe do të marrë bashkia , për këto kafshë rrugësh. Kam 12 vjet që merrem. 8vjet ka qenë 90% Bashkia e Vlorës...Kërkoj që Bashkia Vlorë, ta ketë në vëmendje. Unë nuk marr asnjë fond nga Bashkia Vlorë. Është shumë e rëndësishme. Në qytetin tonë turistik, është shumë rrezik. A ka Bashkia Vlorë, në këtë buxhet një fond, të bashkëpunojë me grupet e interesit.

Znj. Aulona Veizi /D.D.B- Është një sygjërim jo i ri, është problem. Me ristrukturimin që po bëjmë , do ta bëjmë këtë tavolinën e rumbullakët. Po bëhen konsultime.

Znj.Aurora Qarri –Parashtrij kërkesë të banorëve të njësisë Novoselë, nga prindërit e fëmijëve të kopshteve. Problem është mungesa e depozitës së ujit, si dhe shumë urgjente, rikonstruksioni i çatisë së kopshtit, presim dimër. Ky rikonstruksion të bëhet sa më shpejt.

Z.Grigor Dede – Kryqëzimi tek rruga “Dëshmorët”, bëni kurrize, ka shumë aksidente

Znj.Irena Toshkallari/zv/kreytare e bashkisë – Zonja Aurora, për 2 javë boljeri i kopshtit do të vendoset .

Z.Zambak Selmani - Për administratorin, personi zgjidhet nga asambleja e banorëve

-Rruga Panaja – Oshëtimë ...Ne si bashki nuk bëjmë investime në ndriçim.I kemi punëtorë mirëmbajtjeje. Atje ka nevojë për investim.

Znj.Elca Bezhani - Kam dy muaj që e kam ngritur këtë shqetësim.

Z.Zambak Selmani - Do pritet, do parashikohet një fond. Të jemi korrektë.

Znj.Elca Bezhani – Nuk mund ti lëmë në errësirë për disa llampa. Aktiviteti tren për Vlorën, “Aulona Folk”, ka nevojë për ndihmë financiare.

Znj.Irena Toshkallari – Është një kërkesë që do të shqyrtohet. Nuk flas për persona specifikë.

Z.Gjergji Nika – Kur është puna për të kaluar materiale, pasi kalojnë afatet, kemi marrë sms, për këtë vit,” Vlora qyteti i sportit “. Edhe ky aktivitet të shihet.

Znj.Rajmonda Zoto - A janë zbatuar kriteret , kur jepen lejet për lavazhot ?

Znj. Alta Haluci - parkimet poshtë pallateve. Nuk di si funksionon puna e parkimeve për ne rezidentët. Ngelet për tu parë. Vijnë shumë që parkojnë , problem dhe lavazhot.

Z.Simo Petromilo - Në fshatin Sherishtë , problem ndriçimi. Mungojnë llampat. S’ka nevojë për ndonjë investim.

-Problem, rruga “Hysni Alimerko “, ngarkesë në trafik. Në sensin hyrës mungon sinjalistika vertikale. Faleminderit që, pas 2 vjetësh të mungesës së vijave të bardha , zoti Leka e bëri të mundur, por të vendoset sinjalistika vertikale.

Policia bashkiake të kalojë më shpesh në atë rrugë.

Do të marr një takim me drejtorin e policisë bashkiake, për ndryshimin e performancës së punonjësve.

Znj.Frosina Qyrdeti – Thirrje 2 zv/kryetarëve të bashkisë dhe policisë bashkiake , ku pas zonës së “Rosman “-it. Banorët janë shumë të shetësuar. Ajo zonë është kthyer në një landfill, hidhen mbetjet nga bizneset dhe familjet.

Të vini ta shihni dhe ti jepni zgjidhje.

Z.Klodian Xhyheri – Situata tek ish rreth rrotullimi “Dëshmorët “, shqetësim i banorëve, u ngrit dhe nga zoti Dede.

-Ish stacioni i trenit

-Për tecet lundruese , zonja zëvendëskryetare

Znj.Irena Toshkallari /Zv.Kryetare - Po merremi dhe do t’iu kthejmë përgjigje.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Faleminderit për ditën e sotme. Këto pyetje, patjetër që do të marrin përgjigje. Ju uroj festa të gëzuara.

Mbajti Procesverbalin
Zhaneta Gjika